



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
Komisioni Institucional i Zgjedhjeve

V E N D I M

Nr. 02 , Datë 27 / 03 /2025

“Për ngritjen e Komisioneve të Zgjedhjeve në njësitë përbërëse të UT-së dhe fillimin e procesit të vetëkandidimit për anëtarë të tyre”

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Tiranës, si dhe për zgjedhjen e anëtarëve të Komisioneve të Përhershme në Universitetin e Tiranës”, Kreu II, neni 7, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve në UT;

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit të Zgjedhjeve në:
 - Fakultetin e Ekonomisë
 - Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë
 - Fakultetin e Shkencave të Natyrës
 - Fakultetin e Drejtësisë
 - Fakultetin e Shkencave Sociale
 - Fakultetin e Gjuhëve të Huaja
 - Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar
 - Filialin e UT-së, Sarandë
2. Shpalljen e hapjes së procesit të vetëkandidimit për anëtarë të Komisionit të Zgjedhjeve në Fakultete; të Institutit të Fizikës Bërthamore dhe të Filialit të Sarandës, në Universitetin e Tiranës.
3. Regjistrimi i kandidatëve për këto komisione, fillon në datën 28 mars 2025 dhe përfundon në datën 03 prill 2025, nga ora 08.00 – 16.00. Regjistrimi i kandidatëve kryhet pranë Sekretarisë Teknike të







Adresa: Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë



KIZ, pranë Rektoratit të UT-së, ose elektronikisht, në adresën kizut2021@unitir.edu.al, sipas formularëve bashkëngjitur këtij vendimi.

4. Vendimi dërgohet për njohje dhe zbatim në të gjitha fakultetet, Institutin e Fizikës Bërthamore dhe Filialin e Sarandës, të UT-së.
5. Vendimi publikohet në mjediset e fakulteteve; të Institutit të Fizikës Bërthamore dhe të Filialit të Sarandës, të UT-së dhe në faqet e tyre zyrtare.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

- | | | |
|---------------------|-----------|--|
| 1. Migena Buka | (Kryetar) |  |
| 2. Arbër Qoshja | (Anëtar) | (në mungesë) |
| 3. Edlira Çaro Kola | - //- |  |
| 4. Enkelejda Koka | - //- |  |
| 5. Kristian Kina | - //- |  |
| 6. Manjola Nasi | - //- |  |
| 7. Krenar Goxhaj | - //- |  |

